



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 483/3 prot.

Tiranë, më 21.10.2020

VENDIM
Nr.126, datë 21.10.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 71, DATË 31.5.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 71, datë 31.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 32, datë 19.4.2019, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues Nr. 71, datë 31.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, me shkresën nr. 954 prot., datë 15.06.2020, *“Informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Vendimit të Komisionerit nr. 71, datë 31.05.2020”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me DAP, me Urdhrin nr. 21, datë 3.2.2020, ka miratuar strukturën organizative të tij, duke përfshirë në të një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore.
2. Me shkresën nr. 10205/2 prot., datë 31.5.2019 *“Mbi zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike formularin e vlerësimit të punës për anëtarin e TND-së, nëpunësen *****.
3. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka plotësuar dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë në aneksin nr. 2 (*pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes*).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 71, datë 31.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 71, datë 31.5.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha